

Date 20.07.2018
Nr.103



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 7637 Prot.

Tiranë, më 16 . 07 . 2018

URDHËR

NR. 421 , DATË 16 . 07 . 2018

PËR

HAPJEN NË KOLEGJIN UNIVERSITAR "REALD", TË PROGRAMIT TË
STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL NË "ASISTENT ADMINISTRATIV"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 18, 35, 69 dhe 72 të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Hapjen në Kolegjin Universitar "Reald", të programit të studimit me karakter profesional në "Asistent Administrativ", që realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë profesionale "Asistent Administrativ", referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit me karakter profesional në "Asistent Administrativ", fillon në vitin akademik 2018-2019.
3. Kolegji Universitar "Reald", të plotësojë rekomandimet e ekspertit dhe t'i nënshtrohet procesit të akreditimit lidhur me këtë program studimi, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin Kolegji Universitar "Reald".
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar "Reald".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

